



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:031136

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05807946

KF.nr.132/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “S.G.” B.I. – NTT “Zhur Tours”, me numër unik identifikues 811289059 dhe seli në rr. “UÇK”, Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Jeton Osmani avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 27.05.2024 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse avokat Jeton Osmani, dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “S.G.” B.I. – NTT “Zhur Tours”, me numër unik identifikues 811289059 dhe seli në rr. “UÇK”, Prizren, si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi nr.prot.553/2019 i datës 23.01.2020 i Administratës Tatimore të Kosovës, me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, me padinë e paraqitur në Gjykatë më datë 28.02.2020, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, duke kërkuar anulimin e vendimit nr. prot. 553/2019 të datës 23.01.2020. Përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, theksoi se e paditura pa të drejtë dhe pa bazë ligjore e ka ngarkuar paditësin me tatime shtesë dhe ndëshkime administrative, duke bërë një vlerësim të gabuar të

gjendjes faktike dhe duke nxjerrë një konkluzion të pasaktë. Paditësi i kërkoi Gjykatës që vendimin e kontestuar ta anulojë në tërësi si të paligjshëm dhe të obligojë të paditurën që të kthejë mjetet e paguara në emër të tatimeve sipas raportit të kontrollit.

E paditura, në përgjigjen e saj ndaj padisë më datë 26.04.2021, deklaroi se kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi si të pabazuara në ligj dhe fakte, duke vlerësuar se vendimi i ATK-së nr. 553/2019 ka mbështetje ligjore dhe faktike dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Ajo shtoi se pas përfundimit të draft raportit, paditësi nuk ka pasur vërejtje. Inspektorët e kontrollit e kanë dërguar raportin e kontrollit tek Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative (ZGJONA), e cila ka konstatuar se për shkak të mos mbajtjes së librave dhe regjistrimeve siç kërkohet nga legjislacioni tatimor në fuqi, paditësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 53 (53.2.4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.05.2024, për të paditurën nuk ka prezantuar askush, por me parashtresën e datës 24.05.2024 ajo ka njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantojë në këtë seancë dhe ka kërkuar që gjykata të veprojë sipas nenit 38 paragrafi 5 i Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktin Administrativ.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 28.05.2024, ka administruar provat si në vijim: Vendimi nr. 553/2019 i datës 23.01.2020, Vendimi ZGJONA nr. 436/2019 i datës 29.10.2019, Draft raporti i kontrollit nr. 2202/2019 i datës 22.10.2019, Ankesë e datës 04.12.2019, Raporti i kontrollit datës 29.10.2019, Përgjigje në padi e datës 26.04.2021, Ekspertizë financiare e datës 04.03.2024, Email i datës 01.05.2024, Parashtresë e datës 26.04.2024 dhe dokumentet e ofruara, Parashtresën e ATK-së lidhur me vlerësimin e ekspertizës financiare e datës 08.04.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi dhe shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigjes në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se e paditura ka caktuar kontroll tek paditësi, me objekt kontrolli TVSH për periudhën 01/2016-12/2017, PD për periudhën 2016 dhe 2017 dhe CM dhe WM për periudhën 01/2016-12/2017. Tatimpaguesi, këtu paditësi, me datë 04.12.2019 ka dorëzuar ankesën në Divizionin e Ankesave në ATK, për të cilën ankesë ATK-ja më datë 23.01.2020 ka nxjerrë vendimin nr. 553/2019, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtu paditësit, dhe ndaj këtij vendimi paditësi me padinë e datës 26.04.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Nga vendimi kontestues gjykata konstaton se raporti i kontrollit kishte rezultuar me tatime shtesë dhe ndëshkime ndaj këtu paditësit. Kontrolli është bazuar në informatat e marra nga vetë tatimpaguesi në intervistën fillestare për numrin e udhëtarëve dhe çmimin e biletave për linjat Prizren-Prishtinë-Prizren si dhe linjën Prizren-Zhur-Prizren si dhe krahasimin e të hyrave të deklaruara nga këto linja me shpenzimet e derivateve të ndodhura dhe për të cilat tatimpaguesi nuk ka mbajtur regjistrime konform dispozitave ligjore. Kontrolli ka konstatuar se tatimpaguesi për linjën Prizren – Zhur dhe anasjelltas nuk ka poseduar arkë fiskale duke mos deklaruar të hyrat nga kjo linjë, ndërsa gjatë analizës së shpenzimeve është konstatuar se vetëm shpenzimet e derivateve ka të deklaruara dhe atë në vlerë prej 58,440.44 euro për vitin 2016 dhe 72,787.20 euro për vitin 2017, ndërsa të hyrat e deklaruara nga transporti janë 75,268.30 euro për vitin 2016 dhe 66,489.44 për vitin 2017 pa përfshirë shpenzime të tjera të cilat janë të lidhura me këto të hyra.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të paditësit të paraqitura në padi, përgjigjes në padi dhe shkresave të lëndës, me aktvendimin KF.nr.132/22 të datës 08.02.2024, duke vendosur sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar U.V., me detyrat përkatëse si në dispozitiv të aktvendimit të lartcekur.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 04.03.2024, në sqarim dhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 16.04.2024 nga ana e ekspertit financiar U.V., për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi ku i njëjti ka konstatuar se: *me ekspertizë financiare nuk ka rezultuar diferenca me Raportin e Kontrollit – ATK, prandaj rezultati që shihet në përmbledhjen Konsolidimi që kontrolli i ka përfshirë këto*

lloje të tatimit po ashtu janë verifikuar me ekspertizë financiare. Vlerësoj se metoda dhe mënyra e kalkulimeve dhe vlerësimi është në përputhshmëri me dispozitat e legjislacionit tatimor në Kosovë.

E paditura me parashtrësën e datës 08.04.2024 ka vlerësuar ekspertizën financiare si identike me raportin e kontrollit duke i rekomanduar kështu gjykatës që t'ia falë besimin ekspertizës financiare dhe ta fuqizojë vendimin e departamentit të ankesave nr. 553/2019.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale, mendimit të ekspertit, vlerëson se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me nenin 30 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 përcaktohet se: *“Sikurse është parashikuar në paragrafin 3, të Nenit 19 të Ligjit, kur ekzistojnë rrethanat që bëjnë të vështirë përcaktimin e një detyrimi tatimor për shkak të mungesës së regjistrimeve, regjistrimeve false, apo arsyeve të ngjashme, ATK mund të përdorë metodat indirekte, të cilat janë të përshtatshme për llogaritjen e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Këto metoda mund të përdoren në raste kur nuk janë dorëzuar deklaratat, si dhe në rastet në të cilat ka dyshim se nuk ka saktësi të detyrimit tatimor të deklaruar. 2. Para përdorimit të metodës indirekte, ATK duhet të përcaktojë detyrimin tatimor të saktë duke përdorur metoda direkte të kontrollimit të librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit.*

Sipas nenit 53 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, paragrafi 2 përcaktohet se: *“Çdo person i nga i cili kërkohet të krijojë ose mbajë regjistrime, përfshirë kërkesën për të vendosur numrin fiskal të biznesit në të gjithë kuponët dhe faturat e lëshuara, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe i cili nuk e kryen këtë do t'i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ si vijon: dhe me nënparagrafin specifikon se 2.4 tatimpaguesi me qarkullim vjetor prej pesëqind mijë (500,000) dhe më shumë – ndëshkim administrativ prej një mijë (1,000) Euro.”*

Gjykata gjetjet e raportit të kontrollit dhe konstatimet në vendimin kontestues lidhur me tatimin shtesë dhe ndëshkimin e shqiptuar i konsideron si tërësisht të bazuara, kjo për faktin se tatimpaguesi, këtu paditësi, nuk ka ofruar dëshmi as tek e paditura e as në këtë gjykatë nuk ka ofruar prova me të cilat do të dëshmonte se vlerësimi është kryer në mënyrë të gabuar. Edhe nga

ekspertiza financiare, gjykata konstaton se në gjetjet e inspektorit nuk është vërtetuar se ka pasur ndonjë lëshim gjatë kontrollit.

Andaj, Gjykata vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e të paditurës me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit ndaj vendimit kontestues të të paditurës.

Gjykata vlerëson si të pabazuar pretendimin e paditësit se vendimi i kontestuar është i paargumentuar dhe si i tillë është pa bazë ligjore, kjo për faktin se e paditura ka konstatuar drejtë se tatimpaguesi, këtu paditësi, nuk ka argumentuar të kundërtën e vlerësimit zyrtar të ATK-së siç parasheh neni 19 par 6 i Ligjit Nr. 03/L-222, me të cilin përcaktohet se: *Tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shuma e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë.*

Gjykata edhe pas përfundimit të ekspertizës financiare dhe dëgjimit të ekspertit, aprovoi kërkesën e përfaqësuesit të paditësit për ofrimin e provave shtesë të cilat do të sigurohen nga ish-kontabilisti, mirëpo provat e ofruara nuk ishin të mjaftueshme, përkatësisht ishin jorelevante, andaj edhe ekspertiza financiare nuk mundi të ndryshohet apo plotësohet nga eksperti financiar.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se aktvendimi i kontestuar është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt.

Gjykata konstaton se në këtë kontest tregtar administrativ, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata konstaton se paditësi as në këtë kontest tregtar administrativ nuk ka arritur të paraqesë fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij, ngase me nenin 7.1 të LPK-së, përcaktohet se: *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.* Ndërsa me nenin 319.1 të LPK-së përcaktohet se: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.*

Mbi këtë gjendje të fakteve, deklaramit të palëve, ekspertizës financiare të datës 21.04.2024, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, Gjykata konstaton se vendimi nr. 553/2019 i të paditurës, me të cilin është refuzuar ankesa e këtu paditësit, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi që secila palë të mbartë shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.1 dhe nenit 46 par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.132/22, datë 27.05.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.